



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.520/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, të paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të vendosjes së posterave në objektet politike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me atë.18.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** ankesa Anr.520/2021, të datës 16.02.2021, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.02.2021.

### A r s y e t i m

Me datën 16.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendohet se me datën 13.02.2021 kanë vërejtur disa postera të ngjitura në prona publike. Më tutje theksohet se posterat në fjalë janë të ngjitura në hymje të ndërtesave.

Sipas pretenduesit të ankesës subjekti politik Lista Serbe, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 paragrafi 3.5.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ankesës ia ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lista Serbe të datës 16.02.2021 kërkojnë që ankesa në fjalë të refuzohet sepse ajo është paraqitur pas afatit të paraparë dhe si e tillë nuk duhet të pranohet nga paneli për ankesa dhe parashtrësia. Më tutje pretendojnë se pas kontrollit të Postës së Kosovës mund të vërtetohet se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor, dhe si e tillë nuk duhet të merret në konsiderat nga paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtrësia.

Subjekti politik Lista Serbe, propozon PZAP-in që ankesën ta refuzoj si të pabazuar.

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik LVV, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lista Serbe, me pretendimin se pjesëtarët e kësaj partie kanë vendosur postera në prona publike, madje si provë kanë bashkangjitur disa foto të vendosura në një

objekt. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit Lista Serbe për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik Lista Serbe me datë 06.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndaj subjektit politik Lista Serbe – Dega në Mitrovicë, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, është i pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur ti mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre janë cekur si prova disa fotografi të bashkangjitura në ankesë, por nga ato fotografi nuk mund të vrehen posterat se ku dhe në çfarë objekte janë vendosur ato.

Nga të cekurat më lartë Paneli erdhi në përfundim se pretendimi i palës ankuese nuk është në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 33 pika b) të LZP b), me të cilin theksohet se: *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Në rastin konkret subjekti politik LVV, nuk ka bashkangjitur prova që e bëjnë të besueshme faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka bërë shkelje të dispozitës së lartcekur të pretenduar me ankesë, pasi që e njëjta nuk ka arritur të paraqes prova, për vendosjen e posterave në vendet e pretenduara në ankesë dhe as nuk ka arritur ta dëshmojë se vendosja e posterave është bërë nga Lista Serbe, andaj si e tillë është refuzuar nga ky panel, duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.520/2021 më datën 18.02.2021



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.